



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:010076

Datë: 06.06.2019

Numri i dokumentit: 00345167

Pkr.nr.1/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi, me anëtarët e trupit – gjyqtarët Kymete Kicaj dhe Artan Sejrani, me proçesmbajtësen Shyhrete Sopaj në çështjen penale kundër të akuzuarës B.K nga ..., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar, nga neni 434 par. 1 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 133/17, të datës 27.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Metush Biraj, të akuzuarës B.K dhe mbrojtësit të saj av. K.K nga ..., më datën 10.05.2019, muarr dhe publikisht e shpalli ndërsa me datën 06.06.2019 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara:

B. K., nga i ati R. dhe e ëma F. – e lindur B., e lindur më ... në fsh. ... tani me banim në ..., në rr. ... nr. ..., drejtoreshë e SHFMU „...“ në ..., ka të kryer fakultetin e edukimit, e martuar, nënë e ... fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Sepse në cilësinë e personit zyrtar, në dokumentin zyrtar ka shënuar të dhënat e rreme, e pastaj vet e nënshkruan dhe vulos me vulën e shkollës, në atë mënyrë që në intervalin kohor Shkurt – Mars 2017, si drejtoreshë e SHFMU “...” në ..., lëshon vërtetim me nr. të protokolit të dt. 23.11.2016, në të cilin numër të protokolit ishte i evidentuar emri i nxënëses I. Ç, se S.A, në këtë shkollë ka bërë zëvendësimin e edukatores gjatë pushimit të lindjes për 6 (gjashtë)

muaj, të cilin vërtetim dëshmitarja po atë ditë e dorëzon në DKA në ..., lidhur me një konkurs të shpallur për një vend pune.

- Këso dore ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit zyrtar, nga neni 434 par. 1 të KP.

Andaj, gjykata konformë dispozitave të nenit 7, 17,38,39,46,47,48,49,të KPRK lidhur me nenin 434 par. 1 të KP, e gjykon

ME DËNIM ME KUSHT

Ashtu që ia cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili dënim me burgim nuk do të ekzekutohet nëse në kohën e verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 300 (treqind) Euro, si dhe 50 (pesëdhjetë) Euro për programin për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha në afat prej 15 ditëve, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 133/17, të datës 27.10.2017, kundër të akuzuarës B.K nga ..., për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar, nga neni 434 par. 1 të KP.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit Metush Biraj, ka ngelur në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin e mëparshëm, në procesverbalin e dt. 21.05.2018, sidomos pranë pohimeve të theksuara në pasusin e pestë të faqes 3 dhe në pasusin e dytë të faqes 4, ku në mes tjerash ka deklaruar se nga deklarata e dëshmitares S. A., vërtetohet fakti se e njëjta në vitin 2017 ka kërkuar gojarisht nga e akuzuara që ti lëshohet një vërtetim që e ka kryer praktikën në SHFMU “...” në ... e që i është nevojitur që të konkuroj në vend pune si edukatore në fsh. ...dhe se vërtetimi i vulosur dhe i nënshkruar nga e akuzuara i është dorëzuar dëshmitares, e cila e ka dorëzuar në administratën e DKA-së në Poashtu edhe nga deklarata e të akuzuarës B.K vërtetohet se sipas kërkesës gojore të dëshmitares ia ka lëshuar vërtetimin në fjalë të cilin e ka nënshkruar dhe e ka vulosur vetë, se dëshmitarja e ka kryer praktikën në shkollën e lartëcekur dhe i cili vërtetim i është nevojitur për konkurim sipas konkursit të shpallur. Ka propozuar që e akuzuara të shpallet fajtores dhe se me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, prej rrethanave lehtësuese të merret parasysh qëndrimi korrekt i saj në të gjitha fazat, faktin se e njëjta më parë nuk ka qenë e dënuar, është familjare, nënë e dy fëmijëve, ndërsa prej rrethanave rënduese të ketë parasysh peshën e veprës penale, pasojat e saja, e sidomos shkallën e përgjegjësisë, duke marrë parasysh se ky veprim inkriminues është kryer në një institucion edukativo-arsimor.

Poashtu edhe mbrojtësi i të akuzuarës avokat K. K., gjatë fjalës përfundimtare ka ngel në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dorëzuar me shkrim me dt. 21.05.2018, duke shtuar se prokuroria aktakuzën e bazon në provat të cilave nuk i dihet prejardhja, vërtetim në kopje, për të cilat nuk është vërtetuar vërtetësia asnjëherë. Nuk është vërtetuar as me prova materiale, as nga deklaratat e dëshmitarëve se e mbrojtura e tij me dashje ka pregaditur një përmbajtje të pavërtetë të dokumentit zyrtar, nuk ka pasur asnjë interes që ta bëjë një gjë të tillë, e as që dëshmitarja ka pasur ndonjë përfitim material apo në pozitë. Para jush është përsëritur një fakt, i cili është thënë edhe në shqyrtimin e parë nga dëshmitari kryesor i prokurorisë, i cili edhe sot ishte i bindur se dëshmitarja S. A., pranë shkollës “...” nuk ka përfunduar as praktikën. Qëllimi i kësaj deklarate nga ky dëshmitar, vërteton një pretendim të mbrojtjes se i njëjti ka vetëm qëllim personal hakmarrës dhe se në vend që të ndiqte procedurën administrative për korigjim – anulimin e një vendimi të kësaj shkolle, i njëjti për motivacion privat, hakmarrës, inicon rastin pranë Departamentit të krimeve ekonomike në ... dhe në Prokurori me qëllim që ta përmbush motivacionin personal që të jetë drejtor i shkollës. Ka ngel në tërësi pranë kërkesës me shkrim që trupi gjykues të merr aktgjykim lirues.

E akuzuara B.K, në fjalën përfundimtare në tërësi i ka mbështetur pohimet e mbrojtësit.

Në rastin konkret nuk është kontestues fakti se është lëshuar një vërtetim në emër të dëshmitares S. A, nga drejtoresha e shkollës – këtu e akuzuara B. K., se e njëjta në SHFMU “...” ka zëvendësuar në periudhën kohore gjashtëmuajore edukatoren dhe se ai vërtetim është përpiluar dhe nënshkruar nga drejtoresha e shkollës, e të cilin dokument pastaj dëshmitarja e ka shfrytëzuar dhe ka konkuruar në vendin e punës si edukatore. Mirëpo, kontestuese në rastin konkret është se cilat janë veprimet inkriminuese të të akuzuarës, me të cilat veprime do të mund të formoheshin elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Andaj, bazuar në këtë, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje, duke u bazuar edhe në vërejtjet e Gjykatës së Apelit të dhënë në vendimin e tyre, gjatë shqyrtimit gjyqësor të dt. 07.05.2019, është ndëgjuar dëshmitari S.O i cili në tërësi ka ngelur pranë deklaratave të dhëna në prokurori dhe gjykatë dhe se gjatë shqyrtimit të datës së lartëcekur ka deklaruar se nuk i kujtohet që dëshmitarja S.A ta ketë kryer praktikën në shkollën fillore “...”, ku i njëjti është sekretar. Në shqyrtimin paraprak të dt. 05.04.2018, dëshmitari në fjalë ka deklaruar se diku në muajin shkurt apo mars të vitit 2017 i është thyer zyrja dhe i është marrë libri i protokolit, gjatë vikendit është falsifikuar dokumenti bashkë me librin e protokolit dhe se ditën e hënë kur ka ardhë një palë për të kërkuar një dokumentacion, libri i protokolit ka qenë në zyrën e drejtoreshës B.K dhe se aty në librin e protokolit e ka pa një dokument dhe si e ka pa emrin S. A e ka marrë atë dokument dhe e ka bërë kopje. Kopjen e ka marrë ndërsa origjinalin e dokumentit e ka lënë në protokol. Më vonë kur ka ardhë drejtoresha e ka marrë vërtetimin origjinal, pastaj pasiqë e ka marrë librin e protokolit ka pa se është falsifikuar edhe libri i protokolit, ku ai vërtetim është shkruar me numër të protokolit në emër të nxënësit I. Q të vitit 2016. Ka vërejtur se të dhënat e S. A që ishin aty nuk janë të vërteta, pasiqë të dhënat ishin se S. A kishte punuar si zëvendësuese e një edukatoreje për periudhën për 6 (gjashtë) muaj dhe se dokumenti në fjalë do ti shërbente për punësim. Më tej ka shtuar se vërtetimin që praktikanti e ka kryer praktikën në shkollë mund ta lëshoj drejtori, zëvedës drejtori dhe sekretari i shkollës.

Gjatë shqyrtimit të dt. 07.05.2019, është ndëgjuar edhe dëshmitarja S.A, e cila poashtu ka qëndruar në tërësi pranë deklaratës së dhënë në gjykatë, në shqyrtimin e dt. 05.04.2018, ku në mes tjerash ka deklaruar se në vitin 2014 e ka kryer praktikën profesionale në SHFMU “...” në ... dhe se diku në vitin 2017 ka kërkuar nga drejtoresha e shkollës B.K që t’ia lëshon një vërtetim që e ka kryer praktikën në atë shkollë, të cilin vërtetim edhe e ka marrë nga

drejtoresha. Vërtetimi në fjalë i është dashur për punësim dhe se të njëjtin vërtetim bashkë me dokumentacionin e ka dorëzuar në Drejtorinë e arsimit në ..., ku edhe ka aplikuar. Gjithashtu ka deklaruar se pasiqë është njoftuar nga DKA-ja në ... se ky vërtetim është i pavlefshëm, asnjëherë më nuk e ka përdorur në ndonjë konkurs pune, e as që e posedon më atë vërtetim. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës së lartëcekur, dëshmitarja më tej ka shtuar se vërtetimin e ka marrë nga drejtoresha, nuk e ka lexuar përmbajtjen e dokumentit, pasiqë ka qenë dita e fundit për aplikim dhe të njëjtin dokument së bashku me dokumentet tjera e ka dorëzuar në DKA në ..., ku ka konkuruar në vendin e punës si edukatore.

Gjatë procedurës së provave, në pajtim me palët është lexuar edhe deklarata e dëshmitarit Z.Sh, e dhënë në procesverbalin e dt. 10.04.2018, ku i njëjti në mes tjerash ka deklaruar se gjatë vitit 2016-2017, ka qenë drejtor i Drejtorisë komunale të arsimit në ... dhe se në lidhje me vërtetimin në fjalë se ka gabime është njoftuar më vonë, pasiqë është anuluar konkursi dhe se e ka telefonuar drejtoreshën e shkollës, dhe i ka thënë se dokumenti nuk ka qenë në rregull. Ka pasë raste të rralla kur dokumentet e lëshuara kanë pasë gabime teknike dhe se ato gabime i ka evituar vet, natyrisht e ka ftuar drejtorin dhe kur ka pa gabime të tilla, kontratat nuk i ka nënshkruar, i ka kthyer përsëri prapa që drejtori ti përmirëson ato gabime. Gabimet bëhen pasiqë kryesisht punohet me shabllone dhe se edhe këto vërtetime janë në shabllone. Vërtetimin të cilin e ka lëshuar drejtoresha e shkollës “...” për praktikanten e shkollës S.A, nuk ka patur qasje në atë vërtetim, por në rastin konkret konkursi është anuluar i tëri, jo për arsye të këtij vërtetimi por për arsye tjera dhe se sa i përket këtij vërtetimi është njoftuar më vonë, pasiqë vërtetimet shkojnë te komisioni. Poashtu ka shtuar se e din që drejtoresha B.K ka paraqitur vërejtje me shkrim për punën e sekretarit të shkollës në muajin tetor apo nëntor të vitit 2016 dhe se i ka takuar që të dytë me qëllim që ti largojnë mospajtimet dhe që të merren vesh në mes veti rreth kryerjes së detyrës.

Nga leximi i vërtetimit të SHFMU “...” në ... me nr.të protokolit ... të dt. 23.11.2016, vërtetohet se drejtoresha e shkollës B.K ka lëshuar vërtetim në emër të dëshmitares S.A, se e njëjta e ka bërë zëvendësimin e edukatores gjatë pushimit të lindjes në periudhën kohore prej 6 (gjashhtë) muaj në këtë shkollë dhe se gjatë punës si praktikante ka pasur sjellje të mirë si ndaj nxënësve ashtu edhe ndaj kolegëve të saj.

Nga vërtetimi i SHFMU “...” në ..., me numër të protokolit ... të dt. 23.11.2016, vërtetohet se I. Q, në vitin shkollor 2016/2017 ka qenë nxënëse e rregulltë në shkollën fillore të mesme të ultë “...” në ..., në klasën e VIII.

Me shiqimin në librin e protokolit të SHFMU “...” në ..., nga rubrika ... deri në rubrikën ..., vërtetohet se në numrin rendor ...figuron se është lëshuar një vërtetim në emër të I. Q.

Në mbrojtjen e vet, e akuzuara B. K., gjatë shqyrtimit gjyqësor të dt. 07.05.2019, ka ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin e kaluar, duke cekur se dëshmitari S.O, është ende sekretar i shkollës dhe se ndaj të njëjtit ka inicuar procedur disiplinore, e cila procedur disiplinore lidhet me kohën kur ndaj saj sekretari ka filluar këtë procedurë penale. Ka shtuar se të njëjtën e ka ftuar drejtori i DKA-së Z.Sh, duke i thënë se shkolla ka lëshuar një vërtetim me një gabim teknik dhe se vërtetimi duhet të anulohet dhe pasiqë është kthyer në shkollë, menjëherë i ka thënë sekretarit që vërtetimi duhet të anulohet, mirëpo ai ka qenë në komision disiplinor dhe e ka shfrytëzuar këtë. Sipas procedurave sekretari i shkollës, e që ka qenë detyrë e tij, është dashur që ta anulon vërtetimin me një shkresë apo me dy fjali në vërtetim ku mund të shkruhet “vërtetimi anulohet”, por ai nuk e ka bërë këtë dhe se e njëjta më

nuk është marrë me këtë vërtetim pasiqë nuk ka qenë punë e saj. Ka shtuar më tej se kjo është qështje private – personale mes saj dhe sekretarit dhe se tani sekretari aktual ka qenë ushtrues detyre, në momentin kur e njëjta është emëruar si drejtoreshë. Dëshmitaren S.A nuk e njeh, i kujtohet se e njëjta ka qenë në zyre, i ka tregu se ka qenë praktikante, pasiqë rregjistra nuk ka patur, në bazë të fjalëve të saj ia ka lëshuar vërtetimin, mirëpo përmbajtja e vërtetimit nuk i kujtohet pasiqë është lëshuar në bazë të shabllonit.

Në bazë të provave të lartëcekura, pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, kjo gjykatë ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës B. K, formohen elementet e veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 434 paragrafi 1 të KP, sepse në cilësinë e personit zyrtar, në dokumentin zyrtar ka shënuar të dhënat e rreme, e pastaj vet e nënshkruan dhe vulos me vulën e shkollës, në atë mënyrë që në intervalin kohor Shkurt – Mars 2017, si drejtoreshë e SHFMU “...” në ..., lëshon vërtetim me nr. Të protokolit ... të dt. 23.11.2016, në të cilin numër të protokolit ishte i evidentuar emri i nxënësës I. Ç, se S.A, në këtë shkollë ka bërë zëvendësimin e edukatores gjatë pushimit të lindjes për 6 (gjashtë) muaj, të cilin vërtetim dëshmitarja po atë ditë e dorëzon në DKA në ..., lidhur me një konkurs të shpallur për një vend pune.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata kryesisht e vërtetoi në bazë të deklaratës së dëshmitarit S. O, i cili në dëshminë e vet ka deklaruar se në librin e protokolit ka hasur në vërtetimin e lëshuar nga drejtoresha B.K për dëshmitaren S.A. Këtë fakt e ka vërtetuar edhe vet dëshmitarja S.A, se me kërkesën e saj këtu e akuzuara ia ka lëshuar një vërtetim që e ka kryer praktikën në SHFMU “...” e të cilin vërtetim e njëjta, së bashku me dokumentet tjera ka dorëzuar në konkursin e shpallur pranë DKA-së, në vendin e punës si edukatore. Edhe e akuzuara B.K në mbrojtjen e vet nuk e ka mohuar faktin se ka lëshuar një vërtetim të tillë vetëm në bazë të fjalëve të dëshmitares S.A, pasiqë në atë kohë nuk ka patur rregjistra mbi praktikantët të cilët e kanë kryer praktikën në këtë shkollë.

Gjykata ia fali besimin dëshmisë së dëshmitarit S. O në lidhje me vërtetim e falsifikuar, pasiqë ky fakt përputhet edhe me provat materiale të lartëcekura të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, vërtetimit të SHFMU “...” në ..., me nr.të protokolit ... të dt. 23.11.2016, vërtetim në emër të dëshmitares S.A, se e njëjta e ka bërë zëvendësimin e edukatores gjatë pushimit të lindjes në periudhën kohore prej 6 (gjashtë) muaj në këtë shkollë dhe se gjatë punës si praktikante ka pasur sjellje të mirë si ndaj nxënësve ashtu edhe ndaj kolegëve të saj, vërtetim i lëshuar nga këtu e akuzuara në bazë të kërkesës së dëshmitares S.A, nga vërtetimi i SHFMU “...” në ..., me numër të protokolit ... të dt. 23.11.2016, ku figuron se I.Q, në vitin shkollor 2016/2017 ka qenë nxënëse e rregulltë në shkollën fillore të mesme të ultë “...” në ..., në klasën e VIII, si dhe nga libri i protokolit të SHFMU “...” në ..., ku në numrin rendor ... figuron se është lëshuar një vërtetim në emër të I.Q.

Konform nenit 434, paragrafi 1 të KP, personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhëna të duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, rregjistrin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme, ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme, dënohet me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.

Vepra penale është e kryer me shënimin në dokument të të dhënave të rreme. Në rastin konkret duke marrë parasysh faktin se e akuzuara ka përpiluar dokumentin-vërtetimin me përmbajtje të rreme, me veprime të veta ka kryer veprën penale në fjalë. E akuzuara nuk e

mohon faktin se ka lëshuar një vërtetim të tillë për dëshmitaren S.A dhe se dëshmitarja atë vërtetim e ka përdorë – ka konkuruar në pozitë të edukatores.

Poashtu e akuzuara nuk e mohon faktin se sipas thirrjes së drejtorit të DKA-së, ka shkuar në DKA dhe se pas bisedës me drejtorin e DKA-së, se është bërë një gabim në vërtetim, vet ajo ka kërkuar nga dëshmitari S.O që ta anulon atë vërtetim.

Këto fakte janë vërtetuar edhe me leximin e deklaratës së dëshmitarit Z. Sh i cili ka deklaruar se nga komisioni ka kuptuar se është lëshuar një vërtetim me gabime, e ka ftuar drejtoreshën e shkollës – këtu të akuzuarën dhe ka kërkuar që ai dokument - vërtetim të anulohet.

Gjykata nuk i ka marrë për bazë pohimet e mbrojtësit se ai dokument nuk është përdorur, nga arsyeja se dëshmitarja dokumentin në fjalë e ka përdorë – ka konkuruar për një vend të punës dhe se fakti që konkursi në fjalë është anuluar për arsye të tjera nuk do të thotë se dokumenti nuk është përdorur. Kjo edhe nga fakti se vet dëshmitarja e ndëgjuar S.A ka deklaruar se dokumentin-vërtetimin në fjalë së bashku me dokumentet tjera i ka dorëzuar në DKA në ...ku ka konkuruar sipas konkursit për vendin e punës si edukatore. Andaj, pohimet e mbrojtësit në këtë drejtim janë të pabaza.

Poashtu, gjykata nuk i ka marrë për bazë pohimet e avokatit mbrojtës se e gjithë kjo procedurë është inicuar për hakmarrje nga ana e sekretarit të shkollës, pasi që për gjykatën këto janë vetëm supozime, pohime të paargumentuara dhe jo të provuara, nga fakti se ekziston një vërtetim me përmbajtje të rremë, i lëshuar dhe i nënshkruar nga vet e akuzuara, e të cilin fakt nuk e ka mohuar as ajo gjatë mbrojtjes së dhënë.

Poashtu pohimet e avokatit mbrojtës se nuk është vërtetuar as me prova materiale, as nga deklaratat e dëshmitarëve se e mbrojtura e tij me dashje ka pregaditur një përmbajtje të pavërtetë të dokumentit zyrtar, nuk ka pasur asnjë interes që ta bëjë një gjë të tillë, e as që dëshmitarja ka pasur ndonjë përfitim material apo në pozitë, janë të pabaza pasi që këtu e akuzuara B.K, me dashje ka kryer veprën penale në fjalë – ka qenë e vetëdijshme për përpilimin e vërtetimit me përmbajtje të rremë, pa verifikimin e fakteve, pa u verifikuar paraprakisht se dëshmitarja S.A a e ka kryer praktikën në atë shkollë, a e ka zëvendësuar në periudhën gjashtë mujore edukatoren. Vërtetimin në fjalë e ka lëshuar bazuar vetëm në fjalët e dëshmitares, e ka nënshkruar dhe e ka vulosur, me ç'rast me vetë lëshimin e një dokumenti të tillë është rrezikuar qarkullimi juridik si pasojë e përgjithshme e kësaj vepre penale.

Andaj, bazuar në të lartëcekurat gjykata edhe e shpalli fajtores për veprën penale në fjalë dhe ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv, pasi që paraprakisht vërtetoi se është penalo-juridikisht përgjegjëse.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 38 të KPRK, përkritazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh faktin se e akuzuara nuk ka qenë përpara e dënuar për ndonjë vepër penale, se është hera e parë që bie në kundërshtim me ligjin, mbajtjen korrekte në gjykim, gjendjen familjare- se është e martuar dhe nënë e dy fëmijëve. Pasi që rrethana rënduese nuk gjeti, është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet konformë nenit 38 të KPRK, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së

mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjesisë penale të akuzues dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzues ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzues është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaqërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjesisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit në të gjitha segmentet e tij.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2018:010076, 06.06.2019

**Procesmbajtësja
Shyhrete Sopaj**

**Kyetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.